



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Adem Ahmeti, me vendbanim në f.sh. Rezallë, 41000 Skenderaj –
Republika e Kosovës

E PADITUR REPUBLIKA E SERBISË – Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit
Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit
Vlera e kontestit : 291500 €

1.) Padiësi me 20.03.1999 si rezultat i presionit dhe kërcënimeve nga forcat paramilitare ushtarake serbe së bashku me 8 anëtarët familjes është detyruar me dhunë ta braktis shtëpinë dhe është vendosur në në fshatin Tushilë në shtëpinë e Rasim Osmanit , ku ka qendruar 48 ditë , pastaj ka shkuar në Mitrovicë të Isuf Jashari , aty kanë qendruar 1 muaj prej aty kanë shkuar në Klinikë të Ulët të Zeqir Zeqiri ku kanë qendruar vetëm 10 ditë dhe në fund kanë qendruar 3 javë

2.) Padiësi si rezultati i veprimeve gjenocidiale ,krimeve kundër njerëzimit të ndërmarra nga forcat ushtarake dhe policore të udhëhequra direkt nga qeveria e Serbisë ka pësuar dëme materiale dhe jo materiale , është detyruar me dhunë ta braktis shtëpinë së bashku me anëtarët tjerë të familjes gjithsej 8 antar , i është djegur dhe shkatërruar shtëpia me një sipërfaqe prej 120 metra katror , ky shkatërrim nga ekspertët kompetent klasifikohet si dëmtim i kategorisë së pestë , dëmtime në interiorin shtëpiak duke e përfshirë tekniken e bardhë , pajisjet përkatëse , nuk ka mundur ta punoj token bujqësore për 2 vite , ka pësuar dëm në sektorin e blegtorisë 5 lopë dhe 3 vjeta , i është djegur shtalla , hamari koshi me miser , 6 stogj sane , i është vjedhur traktori dhe rimorkio e traktorit , me pajisjet për punë , kerri dhe vetura

Provë :

Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës , e dt. 10.10.2009 nr. 580 – 192
Deklarata familjare nr. 035/3911 e dt. 12.02.2009
Certifikata mbi të drejtat pronës së paluajtshme U1 – 72015061-00049 e dt. 2/6/2009
Vërtetimi i D.U.M.A nr. 325-23 , të dt. 17.12.2008
2 fotografi të shtëpisë së djegur
Dëshmitarët 1. Hajzer Ahmeti , adresa Rezallë , 41000 Skenderaj R. Kosovo dhe
2. Xhavit Brahimi adresa Likofcë 41000 Skenderaj R. Kosovo

Dëgjimi i padiësit si dhe provave tjera të cilat padiësi do të prezantojë në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës .

4.) Të drejtën për kompensim padiësi e bazon në :

- nenin 185 të LMD (G.Z. e RSFJ , Nr. 29/78) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është parapare që për dëmet e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizik si rezultat i dhunës

dhe terrorit , përgjegjës është „ Bashkësia shoqërore politike “ e ne rastin konkret e paditura ka qen e obliguar aktet e vrasjes , dhunës , terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë se paditëses ti pengoj e jo te ndër marr veprime te tilla kundër ligjore Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (neni 1 Protokoll nr. 1 , neni 2 dhe protokoll nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese te propozuara dhe

1.) pastaj të bien ketë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkes padija e paditësit Adem Ahmeti , me vendbanim në f.sh. Rezallë , 41000 Skenderaj Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbise, respektivisht Qeveria e si pasardhse e juridike e e Qeverisë se me parshme qe në emer të njetes tia kompensoj padiesit Adem Ahmetit demin material dhe jomaterial , duke ja paguar

- shumen prej 19200 € për , për dhimbjen shpirtërore dhe mundimit pas ndjekjes nga shtëpia , banimit në shtëpi te huaja
- shumen prej 50 000 € për shkak te pamundësisë se kremtimit te festave fetare në shtëpi , vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
- shumen prej 180 000 € për shtëpinë dhe lokalin e djegur dhe të shkatërruar
- shumen prej 12800 € për interierin shtepiak
- shumen prej 10100 € për shtalen , hamarin , koshin me miser dhe 6 shtogje sanë
- shumen prej 9600 € për traktorin rimorkion e traktorit , plugjet dhe vllaqat
- shumen prej 9800 € për veturen dhe kombin

, të gjitha këto me kamatën ligjore qe nga ngritja e padisë e deri me pagesën definitive , të gjitha në një afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm .

Pala e paditur ti paguaj shpenzimet procedurale të kësaj çështje juridike afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm .

2.) te bihet

Aktvendim

mbi miratimin e propozimit te paditësit në këtë çështje juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe i shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështirë ekonomike , në kuptim menin 7 te Udhëzimit Administrativ të K.GJ. Nr. 2008/2 . dhe nenit 468 .1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore LIGJI Nr. 03/L – 006 .

Skenderaj , 13.05.2010

Paditësi

Adem Ahmeti

Shtojcë :

1.Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt. 10.10.2009 nr. 580 – 192

2.Deklarata familjare nr. 035/3911 e dt. 12.02.2009

3.Certifikata mbi te drejtat pronës së paluajtshme U1 – 72015061-00049 e dt. 2/6/2009

4.Vërtetimi i D.U.M.A nr. 325-23 , të dt. 17.12.2008

5.Dëshmitarët Hajzer Ahmeti , adresa Rezallë , 41000 Skenderaj R. Kosovo dhe Xhavit Brahimi adresa Likofcë 41000 Skenderaj R. Kosovo

6. 4 kopje te padisë

